

VENDIM
Nr. 183, datë 13.3.2013

PËR SHPËRNDARJEN PJESORE TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRIVE “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SHA DHE “HEC ULËZ-SHKOPET” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 9 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ligjit nr. 93/2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.” dhe të ligjit nr. 94/2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Kufiri i shpenzimeve kapitale, miratuar në ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, shtohet me 12 (dymbëdhjetë) miliardë lekë dhe shpërndahet në nivel programi, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Niveli i deficitit buxhetor, miratuar me ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, shtohet me 12 (dymbëdhjetë) miliardë lekë dhe, njëkohësisht, financimi i deficitit buxhetor nga të ardhurat e privatizimit shtohet me 12 (dymbëdhjetë) miliardë lekë.

3. Ngarkohet Ministri i Financave, pas propozimit të ministrit të fushës, për shpërndarjen e kufirit të investimeve sipas lidhjes 1 në nivel projekti, përpara arkëtimit në Buxhetin e shtetit të të ardhurave nga privatizimet në fjalë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha